



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Data: 08.08.2022 Nr. 463-676
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës	
Lloji i aktit:	Rregullore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 01.08.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Rregulloren për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe:

KONFIRMON

Rregulloren për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022, ka miratuar Rregulloren për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës .

MAPL, konstaton së rregullorja e nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Podujevës është bazuar në nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja c), dhe neni 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 6 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe në nenin 7 të Rregullos (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Rregullorja është miratuar në mbledhjes e Kuvendit të Komunës së Podujevës të datës 29.07.2022, me 24 vota për, për aq sa ishin prezent në votim për miratimin e Rregullos për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

P.S. Neni 5 pika 5.2 e kësaj rregulloreje e cila ka të bëjë me lokalet ne pronësi te komunës duhet te zhvillohen procedurat e konkurrimit përmes ankandit publik ashtu siç përcaktohen me Legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale.

Qëllimi i miratimit të Rregullos për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës është menaxhimi pronës së komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Shpejtim Bulliqi, gradonačelnik opštine Podujevo Hilmi Hoxha, predsedavajući Skupštine opštine Podujevo
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-a Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Venera Çerkini, zamenica generalnog sekretara MALS-a
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS Datum: 08.08.2022 br. 463-676
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština Sanije Dërguti, viša službenica za monitorisanje opština
1. Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	
2. Službenik-ca za izradu pravne procene:	
Predmet:	Razmatranje zakonitosti akta Skupštine opštine
Vrsta akta:	Uredba o utvrđivanju postupaka o davanju na korišćenje opštinske imovine manje od jedne (1) godine

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa članom 81.4 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmenidopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS je dana, 1.8.2022.godine, primilo radi procene zakonitosti Uredbu o utvrđivanju postupaka o davanju na korišćenje opštinske imovine manje od jedne (1) godine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS) je razmotrilo zakonitost dotičnog akta, i:

POTVRĐUJE

Uredbu o utvrđivanju postupaka o davanju na korišćenje opštinske imovine manje od jedne (1) godine.

Obrazloženje

Skupština opštine Podujevo na sednici održanoj dana, 29.7.2022.godine, usvojila je Uredbu o utvrđivanju postupaka o davanju na korišćenje opštinske imovine manje od jedne (1) godine.

MALS, konstatuje da je usvojena Uredba od strane Skupštine opštine Podujevo zasnovana na članu 11, na članu 12 stav 12.2 slovo c), i članu 17 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 6 stav 1.3 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine na članu 7 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupaka o davanju na korišćenje opštinske imovine. Uredba je usvojena na sednici Skupštine opštine Podujevo od 29.7.2022, sa 24 glasova za, onoliko koliko je bilo prisutnih na glasanju za usvajanje Uredbe o utvrđivanju postupaka o davanju na korišćenje opštinske imovine manje od jedne (1) godine.

P.S. U članu 5. tačka 5.2. ove uredbe, koji se odnosi na prostorije u opštinskoj svojini, konkursne procedure moraju se razviti putem javne licitacije u skladu sa važećim zakonodavstvom na snazi koji se odnose na davanju na korišćenje i razmenu opštinske imovine.

Svrha usvajanja Uredbe o utvrđivanju postupaka o davanju na korišćenje opštinske imovine manje od jedne (1) godine je, upravljanje opštinskom imovinom.


Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

		
HYRESE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA		
QENDRA EKZECUTIVE / YLLI I KOSOVËS / GOVERNMENT OF KOSOVA		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		
Ministry of Local Government Administration		
Data / Datum / Date: 01.08.2022		
Niveli organizativ / No. / Grades	Vlera	
-VI-	463-676	

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË (1) VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Podujevë
Korrik 2022

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja e) dhe nenin 17 shkronja e) të Ligjit nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 6 paragrafi 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 7 të Rregullores nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.3, dhe nenin 19 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/-1-0050862/18 të datës 29.06.2018. Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2022, miratoi këtë.

**RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK
SE NJË (1) VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen, kriteret kushtet dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për interes publik, për përdhën më pak se një (1) vit.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet e Komunës, personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Podujevës.

**Neni 3
Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin, siç është përkufizuar në Ligjin Nr.06 L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës bëhet duke u bazuar në këto parime:

1.1. **Parimi i ligjshmërisë** - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të Komunës, duhet të bazohen në Kushtetutë, Ligj dhe aktet e tjera nënligjore.

1.2. **Parimi i efikasitetit** - nënkupton se organet e Komunës zhvillojnë procedurën për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, sa më shpejtë dhe sa më pak shpenzime për Komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal.

1.3. **Parimi i trajtimit të barabartë të palëve** - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve:

1.4. **Parimi i transparencës** - nënkupton se organet e Komunës duhet të veprjnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lirisht me procedurat, kushtet dhe ocuringë e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës:

1.5. **Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të Komunës** - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën t'a shfrytëzojë në mënyrë që të ruajë vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlerë:

1.6. **Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës** - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet t'a shfrytëzojë pronën vetëm sipas destinimit të pronës, duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një (1) vit

1. Komunitat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës për më pak se (1) vit.
2. Pronat e paluajtshme të Komunës të cilat mund të jepet në shfrytëzim për më pak se (1) vit, janë:

2.1. Hapësirat publike, (parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese etj):

2.2. Shtëpitë e kulturës, kinematë, teatrot dhe terrenet rekreative-sportive:

2.3. Hapësirat publike para lokaleve afariste:

2.4. Lokalet në pronësi të Komunës:

2.5. Hapësirat publike rreth vend punishteve.

3. Kompensimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një (1) vit përcaktohet me Rregulloren e Komunës për taksat, tarifa dhe gjopa komunale.

Neni 6

Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit jepet, duke u bazuar në kriteret vijuese:

- 1.1. Të jetë e regjistruar si pronë e Komunës në regjistrat kadastrale të pronës;
- 1.2. Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;
- 1.3. Të mos ketë ndonjë kontest pronësor;
- 1.4. Të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor;
- 1.5. Të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;
- 1.6. Të ketë arsyeshmërinë e interesit publik;
- 1.7. Të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik të Komunës;
- 1.8. Të ndikojë në rritjen e vlerave, diversitetit arsimor, kulturor-sportiv dhe të ngjashme.

Neni 7

Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për periudhën më pak se një (1) vit

1. Prona e paluajtshme e Komunës jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët shprehin interesim përmes një kërkesë zyrtare me shkrim.
2. Kërkesa duhet t'i drejtohet organit kompetent - drejtorisë përkatëse:
 - 2.1. Për dhënien në shfrytëzim të objekteve kulturore, rinore dhe sportive, kërkesa i drejtohet Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit;
 - 2.2. Për dhënien në shfrytëzim të lokaleve në pronësi të Komunës, kërkesa i drejtohet Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë;
 - 2.3. Për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike dhe rreth vend punishteve, kërkesa i drejtohet Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
3. Prona e cila jepet në shfrytëzim mbi bazën e kërkesës së aplikuesit, duhet të shfrytëzohet vetëm për destinimin e kërkuar.

Neni 8

Kushtet për aplikim

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për të marrë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës duhet të bashkëngjisin këto dokumente:
 - 1.1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara nga drejtoria përkatëse;
 - 1.2. Kopja e letërnjoftimit për personat fizik ;
 - 1.3. Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik ;
 - 1.4. Historiati i biznesit që aplikon ;
 - 1.5. Veprimtaria që do të zhvillojë;
 - 1.6. Projekti ideor;
 - 1.7. Vërtetimi nga Komunitat për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe taksave komunale;
2. Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në aplikimin për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e drejtorisë përkatëse .

Neni 9

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për Organizatat e Shoqërisë Civile

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së Komunës për organizatat e shoqërisë civile për periudhën më pak se një (1) vit jepet me procedura të njëjta siç është përcaktuar me këtë Rregullorë.
2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për organizatat e shoqërisë civile jepet nga një (1) ditë deri në dhjetë (10) ditë të cilat kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarive në kuadër të kompetencave vetanake të Komunës, për promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, rinore, arkitekturën historike, e të ngjashme.
3. Organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë për qëllim ushtrimin e aktiviteteve të cekura në paragrafin 2 të këtij neni prona e paluajtshme iu jepet në shfrytëzim vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i Drejtorisë gjegjëse, duke përfshyuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.
4. Organizatat e shoqërisë civile të cilat ushtrojnë veprimtarinë apo aktivitetet rehabilituese për personat me nevoja të veçanta, prona e paluajtshme e Komunës mund të iu jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i Drejtorisë gjegjëse, duke përfshyuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.

Neni 10

Formimi dhe përbërja e komisionit vlerësues

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit vlerësues, i cili në bazë të kësaj Rregulloreje ka kompetencë dhe autoritet të jep në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës.
2. Komisioni përbëhet prej tre deri në pesë (3-5) anëtarëve nga drejtoritë përkatëse, ku kryesues i komisionit do të jetë zyrtari nga drejtoria së cilës i është drejtuar kërkesa për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Komisioni ka për obligim, që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit, të shqyrtojë kërkesën, duke konstatuar gjendjen faktike në teren, se a është në harmoni dhe përputhshmëri me arsyeshmërinë e kërkesës.
4. Pas shqyrtimit të kërkesës, komisioni përgatitë raport përfundimtar dhe rekomandon palën e përzgjedhur/përfituese.
5. Mandati i komisionit do të jetë dy (2) vite.

Neni 11

E drejta e ankesës

1. Pala e pakënaqur kundër procesit të vlerësimit të kërkesës ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave të Komunës, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave.
3. Komisioni përbëhet prej tre (3) anëtarëve, ku njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist, ndërsa të tjerët profesionist sipas drejtorive përkatëse.
4. Komisioni për ankesa brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të ankesës bën shqyrtimin e ankesës.
5. Vendimi i komisionit të ankesave për miratimin apo refuzimin e ankesës së palës është përfundimtar në procedurën administrative në Komunë.

6. Pala e pakënaqur me vendimin e komisionit të ankesave brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh (30) nga dita e marrjes së vendimit, mund të iniciojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente, mirëpo nuk e shtynë zbatimin e vendimit.
7. Mandati i komisionit për shqyrtimin e ankesave do të jete dy (2) vite.

Neni 12

Konflikti i interesit

1. Anëtarët e Komisionit vlerësues përjashtohen nga procesi vlerësues dhe vendimmarrës, nëse ai/ajo ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin e ankesave përjashtohen nga procesi i shqyrtimit të ankesave nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 13

Nënshkrimi i kontratës

1. Bazuar në rekomandimin e komisionit vlerësues dhe pas kalimit të afatit të ankesës, Kryetari i Komunës nënshkruan kontratën me të përzgjedhurin/përfshuesin, në të cilën përfshihen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
2. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës më pak se një vit, nuk mund të bartet te personat e tretë.

DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 14

Mbikëqyrja e kontratës

1. Drejtoria përkatëse bën mbikëqyrjen e realizimit të kontratës se a është duke e shfrytëzuar pala sipas kushteve të kontratës.
2. Në rast të mos përmbushjes së kontratës, apo shmangies nga qëllimi për të cilin është marrë prona në shfrytëzim sipas kërkesës së palës, drejtoria përkatëse do të përgatis raport përfundimtar me të cilin do t'i rekomandojë Kryetarit të Komunës për shkëputje të njëanshme të kontratës.
3. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit përfundimtar të përgatitur nga drejtoria përkatëse, duke u bazuar në rekomandimin e dhënë do ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme, duke e njoftuar shtatë (7) ditë para ndërprerjes së kontratës palën kontraktuese.
4. Komuna është e obliguar që të publikojë listën e pronave të cilat i kanë dhënë në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
5. Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim bëhet brenda shtatë (7) ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës, në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Neni 15

Mirëmbajtja e pronës së Komunës

Të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale, janë të detyruar t'a mirëmbajnë dhe t'a shfrytëzojnë dhe mbrojnë në mënyrën e caktuar konform kontratës për shfrytëzim.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen dispozitat e akteve administrative komunale të cilat bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregullore.

Neni 17

Konflikti me ligjin

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 18

Zbatimi

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse të Komunës së Podujevës.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren 06/2021.

Nr.prot. 01-662/01-0062841/22
Podujevë, datë: 29 korrik 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha